

Ne i japim përparësi të madhe
shëndetit dhe sigurisë

Politika e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Qershor 2025

V2.1

Përmbajtja

Qëllimi	3
Fushëveprimi dhe Zbatimi	3
Përgjegjësitë tuaja	3
Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë	3
A. Qeverisja	3
B. Udhëzimet dhe Procedurat	4
C. Trajnimi	4
D. Auditimi	4
E. Raportimi i të dhënave	4
F. Pyetjet dhe Përditësimi i Pilitikës	4

Qëllimi

Ne parashohim një mjedis pune të shëndetshëm dhe me siguri për të gjithë; një mjedis në të cilin ne mbrojmë kolektivisht veten dhe kolegët tanë nga dëmtimet; një mjedis në të cilin ne të gjithë kujdesemi për shëndetin tonë.

Ne veprojmë për të promovuar vazhdimisht çështje të shëndetit dhe sigurisë, për të rritur sensibilizimin për shëndetin dhe sigurinë tek punonjësit, kontraktuesit dhe partnerët tanë dhe për të forcuar kulturën e parandalimit të aksidenteve dhe promovimit të shëndetit në të gjitha operacionet tona.

Në të gjitha nivelet e organizatës sonë, ne jemi të përkushtuar që:

- të përmirësojmë vazhdimisht kushtet e shëndetit dhe sigurisë në punë për personelin, kontraktuesit dhe vizitorët tanë, duke identifikuar rreziqet dhe zbutur rrezikun në vendin e punës
- të promovojmë besimin dhe bashkëpunimin për të adresuar në mënyrë efektive çështjet e shëndetit dhe sigurisë dhe të promovojë sjellje të sigurt në të gjitha aktivitetet
- të konsultohemi me punonjësit tanë, kontraktuesit dhe palët e treta bashkëpunuese, duke inkurajuar pjesëmarrjen e tyre në përmirësimin e shëndetit dhe sigurisë në punë
- të menaxhojmë Shëndetin dhe Sigurinë në Punë (OHS) si një sistem i unifikuar i qëllimeve dhe rezultateve të dëshiruara i cili promovon dhe siguron përmirësim të vazhdueshëm
- të sigurojmë pajtueshmërinë me legjislacionin vendas, direktivat normative dhe kërkesat e tjera që lidhen me OHS-në, si dhe me Rregullat Themelore, procedurat dhe rregulloret e sigurisë së Grupit
- të përcaktojmë përgjegjësi dhe llogaridhënie të qarta për përmbushjen e të gjitha kërkesave të OHS-së

Ne u bëjmë thirrje të gjithë punonjësve, kontraktuesve dhe partnerëve tanë që të mbështesin kompaninë tonë në zbatimin e këtij Vizioni për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë dhe të Politikës përkatëse. Ne presim që ata të respektojnë praktikën e sigurta të punës dhe të veprojnë sipas standardeve të larta të OHS-së të cilat janë krijuar dhe miratuar nga kompania jonë.

Fushëveprimi dhe Zbatimi

Politika zbatohet në TITAN S.A. dhe në subjektet që zotëron ose në të cilat mbanë shumicën e aksioneve.

Parimet e Politikës gjithashtu pritët të zbatohen nga partnerët dhe bashkëpunëtorët e TITAN-it, siç janë kontraktuesit dhe furnitorët.

Në zbatimin e Politikës, ne i nënshtrohemi ligjeve të vendeve në të cilat veprojmë dhe jemi të përkushtuar që të respektojmë të gjitha ligjet e tilla në fuqi. Aty ku Politika, procedurat dhe angazhimet tona të jashtme janë më rigorozë se ligjet vendore, ne veprojmë në përputhje me standardet tona.

Aty ku ligji lokal na ndalon të zbatojmë aspekte të caktuara të Politikës, ne i zbatojmë këto ligje lokale dhe përpiqemi të zbatojmë praktikën më të mira.

Përgjegjësitë tuaja

Si punonjës i TITAN-it, duhet:

- Të kujdeseni për shëndetin dhe sigurinë tuaj dhe të tjerëve
- Të jeni plotësisht në dijeni për këtë politikë dhe qëllimin e saj
- Të kuptoni dhe respektoni rregullat e Grupit dhe Njesisë së Biznesit për siguri në punë
- Të jeni në dijeni dhe të zbatoni nga afër procedurat dhe udhëzimet e sigurisë në punë gjatë përgatitjes dhe ekzekutimit të detyrave
- Të keni njohuritë më të fundit lidhur me Shëndetin dhe Sigurinë duke marrë pjesë në trajnimet përkatëse
- Të raportoni çdo veprim të pasigurt, gjendje të pazakontë ose ngjarje me mundësi lëndimi (near miss)
- Të shikoni dhe kontrolloni gjithmonë për çdo rrezik të mundshëm para se të filloni një punë

Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

A. Qeverisja

Komiteti Ekzekutiv i Grupit dhe Kryetari i tij mbështesin Politikën e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë, duke monitoruar progresin, duke hartuar strategji dhe duke vendosur objektiva.

E gjithë struktura e menaxhimit, deri në nivelin fushor, është përgjegjëse për zbatimin e politikës në të gjitha aspektet e saj dhe në të gjitha aktivitetet. Prandaj, kjo politikë mbështetet nga Organizata e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë në nivel të Grupit, Rajonit, Njësive Biznesore dhe vend-punishte.

B. Udhëzimet dhe Procedurat

Operacionet e TITAN-it mbështeten nga një gamë e gjerë udhëzimesh dhe procedurash mbi aspektet organizative dhe teknike të shëndetit dhe sigurisë në punë (OHS). Udhëzimet dhe procedurat janë menduar si shtesa të specializuara dhe specifike për detyrat lidhur me kornizën ligjore ose rregullatorin lokal, të cilat i zëvendësojnë vetëm nëse përcaktojnë një standard më të lartë të OHS-së. Udhëzimet në fuqi mund të gjenden në "**Lidhjet**", në Intranetin e Grupit TITAN.

C. Trajnimi

Për të mundësuar identifikimin më të mirë të rrezikut, zbutjen e rrezikut dhe parandalimin e aksidenteve, ofrohen trajnime për të gjitha operacionet, duke rritur sensibilizimin, duke bërë përsëritje dhe duke shtuar njohuri të reja.

D. Auditimi

Për të monitoruar progresin në performancën e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë, auditimet kryhen nga Grupi për Shëndet, Siguri dhe Mjedis (HSE) dhe nga organizatat e Rajonit për Shëndet dhe Siguri në Pune dhe nga Njësia e Biznesit. Të gjitha çështjet e identifikuara adresohen në plane specifike për veprim, efektiviteti i të cilave përcillet në mënyrë sistematike.

E. Raportimi i të dhënave

Të gjitha operacionet mbledhin dhe raportojnë të dhëna për shëndetin dhe sigurinë në punë për të monitoruar progresin dhe për të bërë planifikime për përmirësim. Të grumbulluara në Njësinë e Biznesit, rajon dhe në nivel të grupit, të dhënat mbështesin analizën dhe planifikimin OHS në të gjitha nivelet e organizatës.

F. Pyetjet dhe Përditësimi i Politikës

Çdo pyetje në lidhje me këtë Politikë duhet t'i drejtohet Zyrës së Grupit për Siguri, Shëndet dhe Mjedis.

Politika do të ndryshohet nga Komiteti Ekzekutiv i Grupit, kur të konsiderohet e përshtatshme, bazuar në përvojën e fituar dhe krijimin e ligjeve dhe jurisprudencës.